

Në bazë të nenit 158-s) pika 1) dhe në lidhje me nenin 31 paragrafi (8) të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve - tekst i konsoliduar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 30/2012), Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimit solli

R R E G U L L O R E

për dokumentacionin e nevojshëm i cili bashkangjitet me kërkesën për marrjen e lejeve në përputhje me ligjin për mbikëqyrjen e sigurimit

I. DISPOZITA TË PRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përshkruhet dokumentacioni i nevojshëm që duhet të dorëzohet me kërkesën për marrjen e lejeve të mëposhtme nga Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve (në tekstin e mëtejme: Agjencia), në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve (në tekstin e mëtejme: Ligji):

1. leje për kryerjen e veprimtarive të sigurimit;
2. leje për fillimin ose futjen e klasës së re të sigurimeve nga kompania e sigurimit;
3. leje për transferimin e portofolit të sigurimit nga kompania e sigurimit;
4. leje për transferimin e veprimtarive të jashtme nga kompania e sigurimit;
5. leje për ndryshime statusi të kompanisë së sigurimit; dhe
6. leje për themelimin dhe punën e filialit të një kompanie të huaj për sigurime.

II. DHËNIA E LEJES PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE TË SIGURIMIT

Neni 2

(1) Për dhënien e lejes për kryerjen e veprimtarive të sigurimit në Agjenci dorëzohet Kërkesë për marrjen e lejes për të kryer veprimtari të sigurimit,

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni do të dorëzohet vetëm në formularin e paraparë: "Kërkesë për marrjen e lejes për kryerjen e veprimtarive të sigurimit (Formulari K-LS)" i cili është bashkangjitur si Aneksi 1 i kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(3) Kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni i bashkëngjitet dokumentacioni vijues:

1. Propozim-statuti i cili duhet të përmbajë të paktën të dhënat e mëposhtme:
 - kompania (shoqëria) dhe selia e kompanisë së sigurimeve;
 - klasa të sigurimit brenda të cilëve kompania e sigurimeve do të kryejë veprimtari siguri;
 - shuma e kapitalit aksionar që kërkohet për themelimin dhe funksionimin e kompanisë së sigurimit;
 - shuma nominale e aksioneve, numëri i aksioneve të secilës gjini dhe klasë, të drejtat, detyrimet, kufizimet dhe përfitimet që rrjedhin nga aksionet;
 - mënyra e marrjes dhe e përfundimit të të drejtave të aksionarëve të shoqërisë së sigurimit;

¹ Teksti i konsoliduar i Rregullores është hartuar në bazë të tekstit të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm që i bashkangjitet kërkesës për dhënien e lejeve në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/2012), Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm i cili i bashkangjitet kërkesës për dhënien e lejeve në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 35/2017) dhe Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm i cili bashkangjitet me kërkesën për dhënien e lejeve në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/2019). Teksti i konsoliduar nuk ka fuqi ligjore. Për qëllime juridike, në procedurën e dhënies së lejeve valide janë vetëm tekstet të cilët janë botuar në Gazetat e lartpërmendura Zyrtare.

- mënyra e administrimit të shoqërisë së sigurimeve dhe përfaqësimi i shoqërisë nga anëtarët e bordit të drejtorëve;
 - lloji, përbërja, numëri, mënyra dhe kushtet e zgjedhjes, afati, të drejtat, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të organeve të shoqërisë së sigurimeve;
 - procedura për mbledhjen dhe thirrjen e kuvendit;
 - mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet aksionarëve të kompanisë së sigurimit;
 - mënyra e zgjidhjes së konflikteve të interesit dhe ruatja e konfidencialitetit të të dhënave të kompanisë së sigurimit;
 - mënyra e ndryshimit të Statutit të shoqërisë së sigurimit;
 - kushtet dhe rastet e përfundimit të punës së kompanisë; dhe
 - të dhëna të tjera sipas ligjit.
2. Plani i punës së kompanisë së sigurimit, i cili duhet të përmbajë të paktën të dhënat e mëposhtme:
- bazat e politikës tregtare të kompanisë së sigurimit me arsyetim, gjegjësisht analizë të arsyeve për themelimin e kompanisë, objektivat tregtare të kompanisë, shqyrtimin e tregut në të cilën do të marrë pjesë kompania e sigurimeve, strukturën e klientëve të kompanisë së sigurimit dhe të dhëna të tjera;
 - klasat e sigurimit brenda së cilës kompania e sigurimit do të kryejë veprimtari sigurimi;
 - parimet e risigurimit, përfshirë këtu tabelat e mbulimit maksimal për të gjitha klasat e sigurimit, brenda të cilave kompania e sigurimeve do të kryejë veprimtari sigurimi;
 - llogaritja e nivelit të duhur të marzhit të aftësisë paguese sipas neneve 75 ose 76 të Ligjit;
 - vëllimi i planifikuar i kostove për themelimin, kostove organizative dhe kostove të zhvillimit;
 - vlerësimin e likuiditetit, si dhe burimet financiare të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve dhe sigurimin e nivelit të nevojshëm të marzhit të aftësisë paguese;
 - raport me parashikim të rezultateve të pritura tregtare për të paktën një periudhë tre-vjeçare, kryesisht në lidhje me të ardhurat e primit, humbjet e pritura, shpenzimet për realizimin e sigurimit, fitimin e pritur dhe shumën e rezervave teknike dhe të tjera. Raporti duhet të përfshijë:
 - bilanc të hollësishëm të gjendjes, bilanc të suksesit (të të ardhurave) dhe pasqyrë të fluksit të parave me koment për secilin pozicion dhe supozimet themelore mbi të cilat bazohet projeksioni,
 - lëvizjen e treguesve financiarë dhe standardeve mbikëqyrëse, siç janë vëllimi i kapitalit, niveli i kërkuar i marzhit të aftësisë paguese, sasia e provigjioneve teknike, aktivet që mbulojnë provizionet teknike, treguesit e likuiditetit dhe përfitimit dhe të dhëna të tjera;
 - përshkrim të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm;
 - selinë qendrore të kompanisë së sigurimit, si dhe numrin dhe vendndodhjen e filialeve, ekspoziturave dhe formave të tjera organizative, si dhe afatin kur kompania e sigurimit synon t'i hapë ato;
 - strukturën organizative të kompanisë së sigurimit me një përshkrim specifik të fushës së punës dhe përgjegjësi të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të secilës njësi organizative, marrëdhëniet mes tyre dhe marrëdhëniet me organet drejtuese dhe mbikëqyrëse të shoqërisë së sigurimit, si dhe përshkrimin e numrit të kërkuar të punonjësve dhe strukturën e kualifikimit të tyre;
 - specifikimi i fondeve të disponueshme të shoqërisë së sigurimit të cilat janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet jomonetare (mjete për ndihmë), nëse kompania e sigurimit synon të kryejë veprimtari sigurimi në klasën e sigurimit nga ndihma turistike.
3. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të sigurimit dhe normat e primit në lidhje me klasat e sigurimeve të nenit 5 pika 2 dhe 10 të Ligjit, së bashku me bazat teknike për llogaritjen e tarifave, si dhe mendimin e një aktuari të autorizuar në lidhje me to;
4. Propozim-aktet e tjera të politikës tregtare të shoqërisë së sigurimit, si më poshtë:
- 4.1 Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të sigurimit dhe normat e primit në raport me klasat e sigurimit në kuadër të të cilave kompania synon të kryejë veprimtari sigurimesh, përveç

atyre të përmendura në pikën 3 të këtij paragrafi, së bashku me bazat teknike për llogaritjen e tarifave, si dhe mendim nga një aktuar i autorizuar në lidhje me to;

- 4.2 Rregullore për krijimin e provigjoneve teknike dhe/ose provigjonit matematikor të sigurimit dhe politikë për administrimin e mjeteve që mbulojnë provigjonet teknike dhe/ose provigjonin matematikor;
 - 4.3 Rregullore për vendosjen e fondeve të provigjoneve teknike;
 - 4.4 Rregullore për krijimin e një fondi për parandalim si dhe menaxhimin dhe përdorimin e fondit, nëse krijimi i fondit për parandalim është paraparë në Statutin e kompanisë;
 - 4.5 Program për risigurim;
 - 4.6 Rregullore për realizimin e rekurseve dhe
 - 4.7 Propozim-akte të tjera.
5. Dëshmi se janë paguar mjetet monetare në emër të kapitalit aksionar në një llogari të veçantë provizore të një bartës i operacioneve të pagesave, d.m.th. dëshmi se personi juridik ose fizik i huaj - parashtruesi/aplikanti ka paguar fondet devizore në një llogari të veçantë devizore në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë;
 6. Listë e aksionarëve të shoqërisë së sigurimit, duke shënuar emrin dhe mbiemrin, vendbanimin dhe adresën e personave fizikë, d.m.th. emrin dhe selinë e personave juridikë, si dhe të dhënat për shumën totale nominale të aksioneve të mbajtura dhe përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin aksionar të kompanisë së sigurimit;
 7. Dokumentacioni në bazë të të cilit vërtetohet se janë plotësuar kushtet në lidhje me anëtarët e propozuar të organit drejtues, e cila është paraparë për dhënien e miratimit për kryerjen e funksionit anëtar i organit drejtues në Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e kërkuar për marrjen e pëlqimit nga Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve në përputhje me Ligjin për mbikëqyrjen e sigurimeve;
 8. Dokumentacioni në bazë të të cilit vërtetohet se janë plotësuar kushtet në lidhje me anëtarët e propozuar të organit mbikëqyrës, siç janë:
 - 8.1 Deklaratë nga personi i propozuar si anëtar i organit mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit, se nuk është anëtar i organit drejtues, organit mbikëqyrës ose prokurues në ndonjë kompani tjetër të sigurimeve ose institucion tjetër financiar me seli në Republikën e Maqedonisë;
 - 8.2 Dokument - informacione nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, se ku personi i propozuar për anëtar i organit mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit, është anëtar i një organi drejtues, organit mbikëqyrës, prokurues ose person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në persona të tjerë juridikë me seli në Republikën e Maqedonisë.
 - 8.3 Vërtetim nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë ose ndonjë regjistër tjetër publik që nuk ka sanksione kundërvajtëse ose ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës në fushën e sigurimeve dhe financave;
 - 8.4 Vërtetim nga procesverbali penal i gjykatës kompetente se personi nuk është dënuar me aktgjykim gjyqësor fuqiplotë me dënim me burg pa kusht për më shumë se gjashtë muaj, për sa kohë që zgjasin pasojat juridike të vendimit, për vepra penale kundër patundshmërisë, vepra penale kundër financave publike, operacioneve të pagesës dhe ekonomisë, vepra penale ndaj detyrës, si dhe vepra penale falsifikim i dokumenteve, raste të veçanta të falsifikimit të dokumenteve, falsifikim kompjuterik, përdorimi i dokumenteve me përmbajtje të pavërtetë si dhe mosrespekti ndaj të Drejtës Penale.
 - 8.5 Deklaratë nga personi i propozuar si anëtar i organit mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit se ai nuk ka kryer funksionin e një personi me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në një kompani të sigurimeve ose person tjetër juridik, mbi të cilën është zbatuar një administratë speciale ose kundër të cilës janë filluar procedurat e falimentimit ose të likuidimit;
 - 8.6 Deklaratë nga personi i propozuar si anëtar i organit mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit,

se ai /ajo është i vetëdijshëm dhe do të respektojë dispozitat e Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, sipas të cilit personi i propozuar si anëtar i organit mbikëqyrës i shoqërisë së sigurimit nuk duhet të jetë i lidhur me një person juridik, në të cilin kompania e sigurimit drejtpërdrejt ose indirekt posedon më shumë se 10% të kapitalit ose të të drejtave të votimit për atë person juridik;

- 8.7 Deklaratë nga personi i propozuar si anëtar i organit mbikëqyrës të kompanisë së sigurimit se ai nuk do të punësohet në shoqërinë e sigurimit;
 - 8.8 Deklaratë nga personi i propozuar si anëtar i organit mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit, e dhënë me përgjegjësi të plotë penale dhe materiale, se nuk ka punuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
 - 8.9 Deklaratë nga personi i propozuar si anëtar i pavarur i organit mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit, se personi ose anëtar i familjes së tij të ngushtë: (1) në pesë vitet e fundit nuk ka pasur ndonjë interes material ose marrëdhënie biznesi me kompaninë, direkt, si partner afarist, si anëtar i organit drejtues, organit mbikëqyrës ose si person drejtues (2) në pesë vitet e fundit nuk ka marrë ose nuk merr asnjë të ardhur shtesë përveç pagës së kompanisë (3) nuk ka lidhje të ngushta familjare me ndonjë prej anëtarëve të organit drejtues, organit mbikëqyrës ose (4) nuk është një aksionar që posedon më shumë se një të dhjetën e aksioneve të shoqërisë ose nuk përfaqëson një aksionar që posedon më shumë se një të dhjetën e aksioneve të kompanisë.
9. Propozim-kontratat për kryerjen e veprimtarive të jashtme, nëse kompania e sigurimit planifikon të autorizojë subjekte të tjera për kryerjen e veprimtarive të jashtme;
 10. Dokumentacioni mbi bazën e të cilit mund të konkludohet se kompania e sigurimit është e pajisur në aspektin kadrovik, teknik dhe organizativ për kryerjen e aktiviteteve të parashikuara me aktin e themelimit të shoqërisë së sigurimit me të dhëna për sistemin informatik dhe gatishmëri teknike të kompanisë (shoqërisë) për sigurime.
 11. Raporti për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit për revizion(auditim) të brendshëm dhe Rregullat për menaxhimin e rrezikut;
 12. Të dhëna për aktuarin e autorizuar që kryen aktivitetet aktuariale në shoqërinë e sigurimit me prova që personi i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 112 të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, së bashku me një shkresë për qëllime që të lidhë një kontratë angazhimi të aktuarit të nënshkruar nga themeluesit e kompanisë dhe të vërtetuar në një noter ose parakontratë për angazhimin e aktuarit të lidhur midis themeluesit/ve dhe aktuarit;
 13. Të dhëna për personin që do të punësohet si revizor i brendshëm në kompani me prova që personi plotëson kushtet e përcaktuara në Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve dhe Ligjin e auditimit, së bashku me një letër të qëllimeve për të lidhur një kontratë pune me audituesin e brendshëm të nënshkruar nga themeluesit e kompanisë dhe të noterizuar ose parakontraktë për angazhimin e revizorit të lidhur midis themeluesit (ve) dhe audituesit;
 14. Program për zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
 15. Vërtetim nga një aktuar i autorizuar që kompania e sigurimit mund të sigurojë nivelin e kërkuar të marzhit të aftësisë paguese në lidhje me llojin dhe fushën e planifikuar të aktiviteteve dhe
 16. Vërtetim për tarifën e paguar për lëshimin e lejes për kryerjen e veprimtarive të sigurimit, sipas Tarifës së Agjencisë.

(4) Nëse personi i cili synon të themelojë shoqëri ose kompani të sigurimit është person fizik, atëherë përveç dokumentacionit të përmendur në paragrafin (3) të këtij neni, bashkangjitur me kërkesën për marrjen e lejes për kryerje të veprimtarive të sigurimit dorëzohet edhe :

1. Pyetësor i plotësuar për persona fizikë në një formular të përshtatshëm i cili jepet në Shtojcën 3 të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri ose kompani të sigurimit, shoqëri ose kompani për brokerim në sigurim, gjegjësisht shoqëri për përfaqësim në sigurim dhe është pjesë përbërëse e tij. Plotësohen të dhëna (emër dhe mbiemër, vendbanimi dhe numëri i letërnjoftimit) për personin fizik të marra nga letër

- njoftimi, gjegjësisht dorëzohet kopje e pasaportës për personin e huaj fizik. Bashkangjitur me të dhënat për personin fizik, të marra nga letërnjoftimi, dorëzohet deklaratë nga personi se këto janë të dhënat e tij dhe janë të sakta, të vërtetuar nga ana e një personi të autorizuar (noterit).
2. Burimet e mjeteve për pagesën e kapitalit, dhe atë;
 - 2.1 Deklaratë e personit fizik për prejardhjen e mjeteve që investohen si kapital aksionar të shoqërisë ose kompanisë për sigurim gjegjësisht baza për marrjen e aksioneve në shoqëri ose kompani dhe
 - 2.2 Dëshmi e duhur për burimin e mjeteve të cilat personi fizik i investon në kompaninë për sigurim me shumë së paku të barabartë me vlerën nominale të aksioneve të cilat janë lëndë e marrjes (vërtetim për të ardhurat e realizuara të lëshuar nga organi i autorizuar tatimor, dokument për shumën e rrogës dhe të ardhurave të realizuara në baza të tjera, vërtetim për trashigimi, vërtetim nga banka ose ndonjë institucion tjetër financiar për shumën dhe datën e mjeteve të investuara dhe dëshmi tjetër të përshtatshme);
 3. Të dhëna dhe dokumente për gjendjen financiare të personit fizik i cili synon të marrë pjesë në shoqërinë e sigurimit;
 4. Dëshmi nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë ose ndonjë regjistër tjetër publik që nuk ka sanksione kundërvajtëse ose ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës në fushën e sigurimeve dhe financave;
 5. Vërtetim nga evidenca e dëshmisë së penalitetit nga gjykatës kompetentë se personi nuk është dënuar me aktgjykim gjyqësor fuqiplotë me dënim me burg pa kusht për më shumë se gjashtë muaj, për sa kohë që zgjasin pasojat juridike të vendimit, për vepra penale kundër patundshmërisë, vepra penale kundër financave publike, operacioneve të pagesës dhe ekonomisë, vepra penale ndaj detyrës, si dhe vepra penale falsifikim i dokumenteve, raste të veçanta të falsifikimit të dokumenteve, falsifikim kompjuterik, përdorimi i dokumenteve me përmbajtje të pavërtetë si dhe mosrespekti të Kodit Penal.
 6. Deklaratë nga personi fizik se, gjatë tre viteve të fundit, ai nuk ka kryer funksionin e personit me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në kompani të sigurimeve ose ndonjë personi tjetër juridik, mbi të cilën është zbatuar një administratë speciale, ose kundër të cilës janë filluar procedurat e falimentimit ose të likuidimit;
 7. Deklaratë nga personi fizik se ai / ajo është i njohur me dispozitat e Ligjit për mbikëqyrjen e sigurimeve sipas të cilave personi nuk duhet të jetë i lidhur me personin juridik, në të cilin kompania e sigurimeve drejtpërdrejt ose indirekt zotëron më shumë se 10% të kapitalit ose të së drejtave të votimit në atë person juridik;
 8. Deklaratë e personit fizik se personi fizik nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
 9. Listë e personave të lidhur me personin fizik me dëshmi për mënyrën e lidhjes në përputhje me nenin 16-a të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, si më poshtë:
 - 9.1 Deklaratë e personit fizik, për ekzistencën ose mosekzistencën e marrëdhënieve me persona të tjerë që synojnë ta themelojnë shoqërinë, si dhe për lidhjen me persona të tjerë juridikë dhe fizikë, në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, duke deklaruar të gjithë personat që janë lidhur me personin fizik dhe duke siguruar prova për mënyrën e lidhjes;
 - 9.2 Listë e personave juridikë në të cilët personi fizik posedon drejtpërdrejt ose indirekt më shumë se 10% të aksioneve, d.m.th. pjesë, të nënshkruar nga personi fizik;
 - 9.3 Dëshmi nga Regjistri Qendror i letrave me vlerë ose ndonjë regjistër tjetër publik për atë se te cilët persona të tjerë juridikë personi fizik posedon aksione;
 - 9.4 Dëshmi nga Regjistri Qendror ose ndonjë regjistër tjetër publik se ku personi fizik posedon pjesë (aksione) në persona të tjerë juridikë;
 - 9.5 Vërtetim nga Regjistri Qendror ose ndonjë regjistër tjetër publik, për atë se ku është personi fizik anëtar i organit drejtues, i organit mbikëqyrës, prokurues ose person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në persona të tjerë juridikë;
 10. Dëshmi të tjera për vlerësimin e aftësisë kredituese (bonitetit) të personit fizik.

(5) Nëse personi i cili synon të themelojë shoqëri ose kompani të sigurimit është person juridik, atëherë përveç dokumentacionit të përmendur në paragrafin (3) të këtij neni, bashkangjitur me kërkesën për marrjen e lejes për kryerje të veprimtarive në sigurim dorëzohet edhe :

1. Pyetësori i plotësuar për persona juridikë në një formular të përshtatshëm i cili jepet në Aneksin 2 të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri ose kompani të sigurimit, shoqëri ose kompani për brokerim në sigurim, gjegjësisht shoqëri për përfaqësim në sigurim dhe është pjesë përbërëse e tij;
2. Vendim i organit kompetent të personit juridik, për pjesëmarrje në themelimin e shoqërisë (kompanisë) së sigurimit;
3. Burimet e mjeteve për pagesën e kapitalit, si;
 - 3.1 Deklaratë e organit kompetent të personit juridik për prejardhjen e mjeteve që investohen në emër të kapitalit aksionar të shoqërisë ose kompanisë për sigurim, gjegjësisht baza për marrjen e aksioneve në shoqërinë ose kompaninë e sigurimit dhe
 - 3.2 Dëshmi adekuate të burimit të fondeve që personi juridik i investon në shoqërinë e sigurimit me shumë të paktën të barabarta me vlerën nominale të aksioneve që i nënshtrohen përvetësimit (raport revizor i personit juridik, bilanc ose dëshmi tjetër të përshtatshme);
4. Të dhëna dhe dokumente për gjendjen financiare të personit juridik i cili synon të marrë pjesë në shoqërinë e sigurimit;
5. Vërtetim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë ose ndonjë regjistër tjetër publik që nuk ka sanksione kundërvajtëse ose ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës në fushën e sigurimeve dhe financave;
6. Vërtetim nga Regjistri Qendror ose ndonjë regjistër tjetër publik që konfirmon se personi juridik nuk i është nënshtruar një ndëshkimi dytësor dhe atë ndalesë për marrjen e lejes për themelimin dhe punën të kompanisë së sigurimit, anulim të lejes për themelimin dhe funksionin ose punën e kompanisë së sigurimit, ndalesë për themelimin e personave të rinj juridikë dhe ndalesë e përkohshme ose e përhershme për kryerjen e veprimtarive të sigurimit;
7. Dëshmi se nuk ka filluar procedurë falimentimi ose likuidimi ndaj personit juridik, si vijon:
 - 7.1 Vërtetim nga Regjistri Qendror ose ndonjë institucion tjetër kompetent se asnjë veprim i falimentimit ose likuidimit nuk është filluar kundër personit juridik;
 - 7.2 Deklaratë e organit kompetent të personit juridik, se nuk ka filluar procedurë falimentimi ose likuidimi ndaj personit juridik;
8. Deklaratë nga organi kompetent i personit juridik, se ai / ajo është i njohur me dispozitat e Ligjit për mbikëqyrjen e sigurimeve sipas të cilave personi nuk duhet të jetë i lidhur me personin juridik, në të cilin kompania e sigurimit drejtpërdrejt ose indirekt posedon më shumë se 10% të kapitalit ose të drejtave të votës në këtë person juridik;
9. Deklaratë e organit kompetent të personit juridik, se personi juridik nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
10. Listë e personave të lidhur me personin juridik me dëshmi për mënyrën e lidhjes në përputhje me nenin 16-a të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, si më poshtë:
 - 10.1 Deklaratë e organit kompetent të personit juridik, për ekzistencën ose mosekzistencën e marrëdhënieve me personat të tjerë që synojnë ta themelojnë shoqërinë, si dhe për lidhjen me personat të tjerë juridikë dhe fizikë, në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, duke deklaruar të gjithë personat që janë të lidhur me personin juridik dhe duke siguruar prova për mënyrën e lidhshmërisë;
 - 10.2 Listë e personave të cilët në personin juridik posedojnë drejtpërdrejt ose indirekt më shumë se 10% të aksioneve, d.m.th. pjesë, të nënshkruar nga personi i autorizuar i personit juridik;
 - 10.3 Dëshmi nga Regjistri Qendror i letrave me vlerë, gjegjësisht nga ndonjë regjistër tjetër publik lidhur me atë se kush janë bartës të aksioneve, gjegjësisht kush ka pjesë

- (aksione) tek personi juridik;
- 10.4 Listë e personave juridikë në të cilët personi juridik posedon drejtpërdrejt ose indirekt më shumë se 10% të aksioneve, d.m.th. pjesë, të nënshkruar nga personi i autorizuar i personit juridik;
 - 10.5 Dëshmi nga Regjistri Qendror i letrave me vlerë ose ndonjë regjistër tjetër publik se te cilët persona të tjerë juridikë personi juridik posedon aksione;
 - 10.6 Dëshmi nga Regjistri Qendror, respektivisht ndonjë regjistër tjetër publik se ku personi juridik posedon ose zotëron pjesë (aksione) në persona të tjerë juridikë;
11. Akt për themelimin gjegjësisht Statutin e subjektit juridik;
 12. Listë e anëtarëve të organit drejtues të personit juridik (Certifikatë nga Regjistri Qendror ose ndonjë regjistër tjetër relevant publik);
 13. Certifikatë nga regjistri në të cilin është regjistruar zyra qendrore e personit juridik;
 14. Kopje e librit të aksioneve, d.m.th. dëshmi nga një regjistër tjetër publik i përshtatshëm për personin juridik;
 15. Raport i auditimit ose revizionit (Raport për revizionin e kryer të pasqyrave financiare të kompanisë) i përpiluar nga një kompani e autorizuar e auditimit (revizionit) për dy vitet e fundit të punës për personin juridik. Personat juridikë të cilët janë themeluar dhe operojnë për më pak se dy vite detyrohen të dorëzojnë Raport të revizionit ose auditimit të kryer për pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën për të cilën kanë punuar, me gjendje me datë më së shumti një muaj para paraqitjes së kërkesës për marrjen e lejes, si dhe të dorëzojnë raporte të auditimit për dy vitet e fundit të punës për aksionarët e tyre- persona juridikë, d.m.th. të dorëzojnë dokumentacionin përkatës të paragrafit (4) të këtij neni për aksionarët e tyre - persona fizikë, të cilët marrin pjesë në kapitalin e personit juridik me mbi 10%;
 16. dëshmi të tjera për vlerësimin e aftësisë pagueuse të personit juridik, si dhe vlerësimin e aksionarëve të tij, d.m.th. të mbajtësve të aksioneve.

(6) Nëse personi që synon të themelojë një kompani të sigurimeve është **person juridik i huaj** ose një person juridik vendas që është kryesisht në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të personave të huaj fizikë ose juridikë, përveç dokumentacionit në paragrafët (3) dhe (5) të këtij neni, kërkesës për marrjen e lejes për kryerjen e veprimtarisë së sigurimit i bashkangjitet edhe:

1. dëshmi nga kompania e huaj e sigurimit se ka leje ose licencë për të kryer aktivitete sigurimesh në vendlindje, nëse aksionari i huaj është kompani e sigurimeve;
2. mendimi i institucionit të huaj të autorizuar për të mbikëqyrur kompaninë e sigurimeve, nëse aksionari i huaj është kompani ose shoqëri e sigurimeve; dhe
3. raporti i auditimit ose revizionit nga shoqëria ose kompania revizore e nivelit të parë për vitin e fundit të biznesit, nëse aksionari i huaj nuk është kompani për sigurim.

(7) Përveç dokumentacionit në paragrafët (3), (4), (5) dhe (6) të këtij neni, Agjencia mund të kërkojë dokumentacion tjetër shtesë, i cili mund t'i referohet në veçanti por jo vetëm dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve vijuese:

- bilanc ose pasqyrë të gjendjes së llogarisë bankare për një periudhë të caktuar, që ka të bëjë me personin i cili synon të themelojë kompani të sigurimit;
- të dhëna për statusin juridik, gjendjen financiare dhe strukturën e pronësisë së personave që kanë pjesëmarrje të kualifikuar në personin(subjektin) që synon të themelojë kompani të sigurimeve;
- të dhëna për përbërjen e grupit sigurues, bankar ose ndonjë grupi të llojit tjetër, nëse personi që synon të themelojë kompani ose shoqëri është anëtar i një grupi të tillë, me listë të subjekteve të veçanta të grupit dhe përshkrim të lidhshmërisë ose marrëdhënieve të tyre;
- pasqyra të rishqyrtuara financiare të anëtarëve të tjerë në grupin e sigurimit, atë bankar ose në grupin e një lloji tjetër, nëse personi që synon të themelojë kompani të sigurimeve është anëtar i një grupi të tillë, ose të personave të tjerë të lidhur me personin që synon të themelojë kompani të sigurimeve, puna e të cilit mund të ketë një ndikim në punën dhe / ose rreziqet ndaj të cilave do të

ekspozohej kompania e sigurimit.

(8) Përveç dokumentacionit në paragrafin (3), (4), (5), (6) dhe (7) të këtij neni, Agjencia në mënyrë zyrtare siguron dëshmi nga evidenca e saj se personi i propozuar për anëtar i organit mbikëqyrës të kompanisë për sigurim nuk është anëtar i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë.

(9) Dokumentacionin nga paragrafi (4) pika 9 nën-pikat 9.3, 9.4 dhe 9.5, paragrafi (5) pika 7 nën-pika 7.1, pika 10 nën-pikat 10.3, 10.5 dhe 10.6 dhe pikat 13 dhe 14 të këtij neni, Agjencia do të marrë me detyrë zyrtare nga organi publik kompetent (nëse i njëjti nuk dorëzohet nga parashtruesi), për të cilin parashtruesi do të bëjë një deklaratë që autorizon Agjencinë në emër të tij/saj dhe në llogari të tij/saj t'i përdorë të dhënat që janë në formularin K-LS (Deklarata është një pjesë përbërëse e Formularit K-LS) i cili është dhënë në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje dhe në Agjenci paraqet provë për pagesën e kryer në llogarinë e institucionit përgjegjës për lëshimin e dokumentit të duhur në shumën e përcaktuar nga lista e tarifave e përcaktuar me ligj.

(10) Vërtetimin nga paragrafi (3) pika 8, nën-pika 8.4 dhe paragrafi (4), pika 5 të këtij neni Agjencia zyrtarisht do ta marrë nga gjykata përkatëse kompetente (nëse i njëjti nuk dorëzohet nga parashtruesi). Nëse personi është person i huaj, ai/ajo është i detyruar të sigurojë vetë informacionin e tillë nga autoritetet kompetente në vendin e huaj .

(11) Me aftësinë e përshtatshme organizative të kompanisë ose shoqërisë së sigurimeve në pikëpamje të paragrafit (3) pika 10) të këtij neni nënkuptohet themelimi ose krijimi i një organizimi të tillë të kompanisë i cili mundëson kryerjen me sukses të veprimtarisë së saj në vëllimin e specifikuar në Statut dhe Planin e Punës, që vërtetohet me sjelljen e projekt-akteve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, vendimin për organizimin e njësive të punës, rregulloret për punë të revizionit ose auditimit të brendshëm, etj.

(12) Me aftësi të përshtatshme teknike të kompanisë së sigurimit në kuptimin e paragrafit (3) pika 10) të këtij neni nënkuptohet:

- hapësirë tregtare për kryerjen e veprimtarive të sigurimit që i plotëson standardet e kërkuara në lidhje me numrin e planifikuar të të punësuarve;
- Projekt për zbatimin e pajisjeve të përshtatshme informatike dhe zgjidhjes softuerike për kryerjen e veprimtarive të sigurimit, të cilat sipas vëllimit dhe karakteristikave teknike korrespondojnë me numrin e të punësuarve dhe vëllimin e planifikuar të funksionimit të kompanisë së sigurimeve.

(13) Projekti për implementimin e sistemit informatik duhet të përmbajë përshkrim të hollësishëm të infrastrukturës së parashikuar të harduerit dhe softuerit, specifikim të pajisjeve dhe funksionalitetit të aplikacionit, plan për zbatimin me hapa dhe afate të përcaktuara, përshkrim të masave të sigurisë që do të zbatohen si dhe mënyrën në të cilën do të sigurohet vazhdimësia e shërbimeve. Projekti duhet të marrë parasysh standardet e pranuar përgjithësisht për sigurinë e sistemit informatik dhe për të siguruar vazhdimësinë e funksionimit, përveç nëse parashihet ndryshe nga Agjencia. Nëse parashikohet që funksionimi i sistemit informatik të varet nga furnizues të jashtëm (kompani për shërbime ndihmëse), kompania për sigurim duhet të përfshijë dokumentacionin e duhur të marrë nga furnizuesi në vetë projek-planin e tij, me çka do të definohen shumë qartë sasia dhe cilësia e shërbimeve, masat e sigurisë, si dhe karakteristikat e dërgesës.

(14) Me aftësi të përshtatshme kadrovike të kompanisë së sigurimit në pikëpamje të paragrafit (3) pika 10) të këtij neni nënkuptohet struktura e parashikuar e kualifikimit të punonjësve me stazhin dhe përvojën e nevojshme për secilin pozicion specifik pune, si dhe dinamika e planifikuar për plotësimin e vendeve të punës, e cila duhet të ndjekë dinamikën e rritjes së vëllimit të punës dhe zgjerimit të rrjetit organizativ të kompanisë së sigurimeve. Është e nevojshme të tregohet numri i të punësuarve sipas njësive individuale organizative, të dhëna për arsimimin e personave që do të përfshihen në kryerjen e veprimtarive financiare dhe plani për stërvitjen e të punësuarve për tre vitet e ardhshme.

(15) Gjatë vendosjes mbi kërkesën për marrjen e lejes për kryerjen e veprimtarive të sigurimit vlerësohet nëse kompania e sigurimit përmbush kriteret e përcaktuara me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, të paktën nëpërmjet:

- verifikimit të identitetit të personave që synojnë të themelojnë kompani të sigurimit, personave të cilët lidhen me to dhe formën e tyre ligjore;
- verifikimit nëse pozicioni financiar i personave që synojnë të themelojnë kompani të sigurimit është i përshtatshëm në raport me vlerën e aksioneve që ata synojnë t'i fitojnë;
- vlerësimit të mundësive për të mbështetur rritjen e planifikuar të fondeve të vetë kompanisë së sigurimit nga personat që synojnë të themelojnë kompani të sigurimeve;
- verifikimit të burimeve të fondeve, prejardhjes dhe ligjshmërisë së tyre;
- vlerësimit të cilësisë dhe vërtetësisë së planit të punës. Plani vlerësohet nga aspekti i mënyrës së parashikuar të administrimit të rreziqeve në punë, mënyrës së vendosjes së sistemeve për kontroll të brendshëm, realitetit të realizimit të projeksionit të veprimtarive financiare dhe pasqyrave financiare dhe mundësisë për realizimin e planit të aksionarëve për zhvillimin e ardhshëm të kompanisë së sigurimit;
- vlerësimit të tarifave dhe kushteve për sigurim në klasa të veçanta të sigurimeve nga aspekti i përputhshmërisë së tyre me baza teknike për llogaritjen e të njëjtëve;
- vlerësimit të përshtatshmërisë së numrit të kërkuar të të punësuarve në kompaninë e sigurimit për menaxhimin dhe funksionimin e saj efikas dhe të suksesshëm. Me numrin e nevojshëm të të punësuarve nënkuptohet ai numër që na siguron që kompania e sigurimit do të kryejë vëllimin e veprimtarive të planifikuara rregullisht dhe normalisht;
- vlerësimit të kualifikimit, përvojës, trajnimit dhe reputacionit të anëtarëve të organit mbikëqyrës dhe atij administrativ dhe të personave që synojnë të themelojnë kompani të sigurimit për sa i përket veprimtarive të cilat do t'i kryejë kompania e sigurimit;
- vlerësimit të përshtatshmërisë së sistemit informatik dhe pajisjes teknike të kompanisë së sigurimit, për kryerjen e suksesshme dhe të sigurtë të aktiviteteve. Sistemi informatik konsiderohet i përshtatshëm nëse ofron mbështetje të vazhdueshme dhe të besueshme për funksionimin e kompanisë së sigurimit dhe siguron bazën për raportim në kohë dhe të saktë për personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta dhe për Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Kompania e sigurimit duhet të ketë hapësirë të përshtatshme tregtare dhe pajisje teknike që mundësojnë funksionimin e saj të sigurtë dhe pa ndërprerje, si dhe përkufizimin e duhur të proceseve tregtare;
- vlerësimit të përshtatshmërisë së strukturës organizative të kompanisë së sigurimit, që nënkupton të paktën definimi i procedurave për punë për të gjitha proceset tregtare që do të zhvillohen në kompani, në përputhje me aktivitetet e planifikuara, definimi i linjave të vendimmarrjes dhe përgjegjësisë dhe vendosja e sistemit të kontrollit të brendshëm në të gjitha proceset tregtare që përfshijnë një nivel të caktuar të rrezikut;
- vlerësimit nëse kompania e sigurimit ka aftësinë për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar rreziqet që do të ekspozohen gjatë kryerjes së aktiviteteve të planifikuara;
- vlerësimit të përshtatshmërisë së sistemit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit e terrorizmit bazuar në proceset e vendosura dhe zgjidhjen softuerike për përcjelljen e rrezikut nga ekspozimi i kompanisë së sigurimit ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- verifikimit nëse në kërkesë ka mospërputhje që nuk mund të shpjegohen

III. DHËNIA E LEJES PËR FUTJEN E NJË KLASË TË RE TË SIGURIMIT

Neni 3

(1) Për dhënien e lejes për një klasë të re të sigurimit nga ana e kompanisë së sigurimit në Agjenci dorëzohet kërkesa për marrjen e lejes për klasën e re të sigurimit.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni do të dorëzohet vetëm në formularin e paraparë: "Kërkesë për marrjen e lejes për futjen e klasës së re të sigurimit (Formulari K-LKS)" i cili është bashkangjitur në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(3) Kërkesës nga paragrafi (1) të këtij neni, kompania e sigurimit i bashkangjet dokumentacionin vijues:

1. Vendim për fillimin e një klase të re të sigurimeve të miratuar nga organi administrues i shoqërisë së sigurimeve;
2. Dokumentacionin e cituar në nenin 2 paragrafi (3) pikat 2, 3, 4, 5 dhe 15 të kësaj rregulloreje;
3. Dëshmi për tarifën e paguar për lëshimin e lejes për fillimin e një klase të re të sigurimit, sipas Tarifës së Agjencisë.

(4) Në të njëjtën kohë me dorëzimin e kërkesës për marrjen e lejes për të filluar një klasë të re të sigurimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtruesi në Agjenci poashtu dorëzon kërkesë për marrjen e miratimit për të ndryshuar statutin e kompanisë së bashku me dokumentacionin i cili parashihet për dhënien e këtij miratimi.

(5) Dokumentacioni shtesë që Agjencia mund të kërkojë, në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, që të vendosë mbi kërkesën për leje për të filluar një klasë të re të sigurimeve, mund të ketë të bëjë veçanërisht, por jo vetëm me dokumentet, të dhënat dhe informacionet vijuese:

- bilanc ose pasqyrë të gjendjes së llogarisë bankare për një periudhë të caktuar, që ka të bëjë me personin i cili synon të themelojë kompani të sigurimit;
- pasqyra financiare të reshqyrtuara të kompanisë së sigurimeve;
- të dhëna të tjera për të vlerësuar përmbushjen e kushteve për futjen ose fillimin e një klase të re të sigurimit.

IV: DHËNIA E LEJES PËR BARTJEN E PORTOFOLIT SIGURUES

Neni 4

(1) Për dhënien e lejes për transfer ose bartje të portofolit sigurues, në Agjenci dorëzohet kërkesë për marrjen e lejes për transfer të portofolit të sigurimit.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni do të dorëzohet vetëm në formularin e paraparë: "Kërkesa për marrjen e lejes për transfer të portofolit të sigurimit (Formulari K-LTPS)" i cili është bashkangjitur si Aneksi 3 i kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(3) Kërkesën për marrjen e lejes për transferimin e portofolit të sigurimeve nga paragrafi (1) i këtij neni në Agjencinë e dorëzon kompania e sigurimit e cila e bart ose e transferon portofolin sigurues.

(4) Kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni i bashkëngjitet dokumentacioni vijues:

1. Vendim për transferimin e portofolit të sigurimit i miratuar nga organi kompetent administrues i kompanisë që transferon portofolin;
2. Vendim për marrjen e portofolit të sigurimit i marrë nga organi kompetent drejtues i kompanisë që merr përsipër portofolin;

3. Kontratë për transferimin e portofolit të sigurimit e lidhur ndërmjet kompanisë që transferon portofolin dhe kompanisë që merr përsipër portofolin;
4. Listë e kontratave të sigurimit sipas klasave dhe nënklasave të veçanta të sigurimit të cilat janë lëndë e transferimit, si dhe kushtet e përgjithshme dhe të veçantë të sigurimit për ato kontrata të sigurimit;
5. Llogaritja e provigjioneve teknike dhe/ose provigjionit matematici të nënshkruara nga një aktuar i autorizuar në lidhje me portofolin që transferohet;
6. Të dhëna mbi mjetet që i mbulojnë provigjionet teknike dhe/ose provigjionin matematicor (sipas llojeve të mjeteve dhe pjesëmarrjes përqindore në mjetete totale të cilat i mbulojnë provigjionet teknike), duke cekur vëllimin dhe të dhënat e tyre mbi bazën e të cilave mund të verifikohet vëllimi, sa i përket portofolit që është lëndë e transferimit;
7. Mendim nga një aktuar i autorizuar që kompania e sigurimit që e merr portofolin e sigurimit, pas marrjes, sa i përket llojit dhe vëllimit të planifikuar të aktiviteteve, do të mund ta sigurojë nivelin e nevojshëm të marginës së marzhit të pagesës;
8. Mendim nga institucioni i huaj i autorizuar për të mbikëqyrur kompaninë e sigurimit e cila e transferon (bartë), gjegjësisht e merr portofolin e sigurimit, nëse kompania e sigurimeve që transferon ose merr portofolin e sigurimeve është një kompani e huaj e sigurimeve;
9. Ndryshime në Planin e punës së shoqërisë së sigurimit e cila e merr portofolin e sigurimeve por që paraqiten si rezultat i transferimit; dhe
10. Dëshmi për tarifën e paguar për lëshimin (marrjen) e lejes për transferin e portofolit të sigurimit, në pajtueshmëri me Tarifën e Agjencisë.

(5) Nëse kompania e sigurimit transferon portofolin e sigurimit në degën ose filialin e saj në një shtet anëtar përpara se të merret vendimi për lëshimin e lejes për transferimin e portofolit të sigurimit, Agjencia do të kërkojë mendim nga organi kompetent për mbikëqyrjen e shtetit anëtar.

V. DHËNIA E LEJES PËR TRANSFERIN E AKTIVITETEVE TË JASHTME

Neni 5

(1) Për marrjen e lejes për transferim ose bartje të aktiviteteve të jashtme, në Agjenci dorëzohet kërkesa për marrjen e lejes për transferim të aktiviteteve të jashtme.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni do të dorëzohet vetëm në formularin e paraparë: "Kërkesë për marrjen e lejes për transfer të aktiviteteve të jashtme (Formulari K-LTAJ)" i cili është bashkëngjitur si Aneksi 4 i kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(3) Kërkesës nga paragrafi (1) të këtij neni i bashkëngjitet dokumentacioni vijues:

1. Vendim për transfer të aktiviteteve të jashtme i miratuara nga organi kompetent administrues i shoqërisë së sigurimit;
2. Kontratë për transferimin e aktiviteteve të jashtme e lidhur me subjektin që i ndërmerr aktivitetet e jashtme me një përshkrim të hollësishëm të veprimtarive që transferohen, të drejtat dhe detyrimet e palëve të kontraktuara, kohëzgjatjen e kontratës, si dhe mënyrën e mbikëqyrjes së subjektit i cili i ndërmerr aktivitetet e jashtme;
3. Të dhëna për statusin juridik, statusin financiar dhe funksionimin e subjektit me të cilin është lidhur kontrata për transferimin e aktiviteteve të jashtme;
4. Deklaratë nga një person i autorizuar i subjektit që ndërmerr aktivitetet e jashtme, të dhënë me përgjegjësi të plotë materiale dhe penale, se Agjencisë do t'i jepet qasje të plotë në të dhënat në

dispozicion të saj/tij me qëllim të zbatimit të papenguar të mbikëqyrjes së punës së shoqërisë ose kompanisë së sigurimit;

5. Dëshmi për tarifën e paguar për lëshimin (marrjen) e lejes për transferin e aktiviteteve të jashtme, në pajtueshmëri me Tarifën e Agjencisë.

(4) Për lëshimin ose dhënien e lejes për transfer të aktiviteteve të jashtme, Agjencia mund të kërkojë plotësimin e kushteve shtesë nga subjektet që pranojnë të kryejnë aktivitetet e jashtme, nëse kjo është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të personave të siguruar.

VI: DHËNIA E LEJES PËR NDRYSHIME TË STATUSIT

Neni 6

(1) Në pikëpamje të kësaj rregulloreje, me ndryshime të statusit nënkuptojmë:

1. bashkimin e dy ose më shumë kompanive të sigurimit ose bashkimin e një ose më shumë kompanive të sigurimeve me persona të tjerë juridikë në një kompani të sigurimit, ku të gjitha kompanitë ose personat juridikë e humbasin identitetin e tyre juridikë dhe krijohet një kompani e re e sigurimit tek i cila kalojnë e gjithë prona dhe detyrimet e kompanive dhe/ose personave juridikë të cilët bashkohen, në këmbim të aksioneve nga kompania e re;
2. bashkangjijtjen e shoqërisë së sigurimit ose një personi tjetër juridik (kompani ose kompanitë bashkangjitime) me një kompani tjetër të sigurimeve (kompani sipërmarrëse), me bartje ose transfer të të gjithë pronës dhe detyrimeve të kompanisë bashkangjitime, pa u zbatuar procedura e likuidimit, në këmbim të aksioneve nga kompania bashkangjitime;
3. ndarja e kompanisë së sigurimit nëpërmjet:
 - shpërndarjes me themelim, me transferim të pronës dhe detyrimeve në dy ose më shumë kompani të reja të sigurimit dhe/ose persona të rinj juridikë, me anë të së cilës shoqëria e sigurimit e cila ndahet përfundon pa zbatimin e likuidimit;
 - shpërndarjes me sipërmarrje, me transferim të pronës dhe detyrimeve në dy ose më shumë kompani ekzistuese të sigurimit dhe/ose persona ekzistues juridikë, me anë të së cilës shoqëria e sigurimit që ndahet përfundon pa zbatimin e likuidimit;
 - veçimit me themelim, me transferim të një pjese të pronës dhe të detyrimeve në dy ose më shumë kompani të reja të sigurimit dhe/ose persona të rinj juridikë, me anë të së cilës shoqëria e sigurimit e cila ndahet nuk përfundon;
 - veçimit me sipërmarrje, me transferim të një pjese të pronës (aktiveve) dhe detyrimeve në dy ose më shumë kompani ekzistuese të sigurimit dhe/ose persona ekzistues juridikë, me anë të së cilës shoqëria e sigurimit që ndahet nuk përfundon;

(2) Për dhënien e lejes për ndryshime të statusit- **bashkim**, në Agjenci dorëzohet kërkesë për marrjen e lejes për ndryshime të statusit - bashkim.

(3) Kërkesa nga paragrafi (2) i këtij neni do të dorëzohet vetëm në formularin e paraparë: "Kërkesë për marrjen e lejes për ndryshime të statusit - bashkim (Formulari K-LNSB)" i cili është dhënë në Aneksin 5 të kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(4) Kërkesës nga paragrafi (2) të këtij neni i bashkëngjitet dokumentacioni vijues:

1. Vendim i autoriteteve kompetente të kompanive ose shoqërive të sigurimeve dhe/ose personave juridikë që bashkohen për të filluar procedurën e bashkimit;
2. Marrëveshje për bashkim të lidhur ndërmjet bordeve mbikëqyrëse të kompanive, d.m.th organeve administruese të kompanive të sigurimit/personave juridikë të cilët bashkohen, e cila duhet të përmbajë të dhënat e përshkruar në Ligjin për shoqëri tregtare;

3. Bilanc fillestar i gjendjes së shoqërisë së re për sigurim nga e cila mund të shihet shuma e kapitalit të saj fillestar. Bilanci fillestar merret pas konsolidimit të kërkesave dhe detyrimeve të ndërsjella të kompanive të sigurimit dhe/ose personave juridikë që bashkohen dhe duhet të kontrollohen nga një revizor/auditues i autorizuar;
4. Dëshmi se shuma e nevojshme e mejteve monetare që kërkohet për të arritur kapitalin fillestar të aksioneve është paguar në llogarinë e përkohshme të bartësit të operacioneve të pagesës, nëse për arritjen e shumës së nevojshme të kapitalit fillestar nevojitet pagesë shtesë e mjeteve monetare;
5. Dokumentacion i përshtatshëm nga neni 2 paragrafi (3) pikat 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe paragrafi (4), (5), (6) dhe (7) të kësaj rregulloreje; dhe
6. Dëshmi për tarifën e paguar për lëshimin e lejes për ndryshimin e statusit, në pajtueshmëri me Tarifën e Agjencisë.

(5) Për dhënien e lejes për ndryshime të statusit- **bashkangjitje**, në Agjenci dorëzohet kërkesë për marrjen e lejes për ndryshime të statusit - bashkangjitje.

(6) Kërkesa nga paragrafi (5) i këtij neni do të dorëzohet vetëm në formularin e paraparë: "Kërkesë për marrjen e lejes për ndryshime të statusit - bashkangjitje (Formulari K-LNSB)" i cili është dhënë në Aneksin 6 të kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(7) Kërkesës nga paragrafi (5) të këtij neni i bashkëngjitet dokumentacioni vijues:

1. Vendim nga organit kompetent i shoqërisë së sigurimit, gjegjësisht i personit juridik që bashkëngjitet dhe i shoqërisë së sigurimit që bashkëngjitet për të filluar procedurën e bashkëngjities;
2. Statuti i ri i mundshëm ose i ndryshuar i shoqërisë së sigurimit e cila bashkëngjitet, i cili duhet të përmbajë të dhënat e parashikuara në nenin 2 paragrafi (2) pika 1 e kësaj rregulloreje.
3. Marrëveshja e bashkëngjities, e lidhur ndërmjet bordit mbikëqyrës të kompanisë së sigurimit, gjegjësisht organit drejtues të personit juridik i cili bashkëngjitet dhe bordit mbikëqyrës të kompanisë së sigurimit e cila bashkëngjitet. Marrëveshja duhet të përmbajë në mënyrë adekuate të dhënat e përcaktuara me Ligjin për shoqëritë tregtare;
4. Bilanc fillestar i gjendjes së shoqërisë së sigurimit e cila bashkëngjitet, nga e cila mund të shihet shuma e kapitalit të saj fillestar. Bilanci i kompanisë që bashkëngjitet merret pas konsolidimit të kërkesave dhe detyrimeve të ndërsjella me kompanitë, përkatësisht personat juridikë që janë duke u bashkëngjitur, i rishqyrtuar nga një revizor i autorizuar;
5. Plan strategjik dhe operacional për arsyetimin ekonomik të bashkëngjities i cili duhet të përfshijë një analizë të nevojës për bashkëngjitje si dhe parashikime të pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit e cila bashkëngjitet, i përpiluar në pajtueshmëri me nenin 2 paragrafi (2) pika 2 të kësaj rregulloreje;
6. Dokumentacion i përshtatshëm nga neni 2 paragrafi (3) pikat 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe paragrafi (4), (5), (6) dhe (7) të kësaj rregulloreje; dhe
7. Dëshmi për tarifën e paguar për lëshimin e lejes për ndryshimin e statusit, në pajtueshmëri me Tarifën e Agjencisë.

(8) Për dhënien e lejes për ndryshime të statusit-**ndarje**, në Agjenci dorëzohet kërkesë për marrjen e lejes për ndryshime të statusit - ndarje.

(9) Kërkesa nga paragrafi (8) i këtij neni do të dorëzohet vetëm në formularin e paraparë: "Kërkesë për marrjen e lejes për ndryshime të statusit - ndarje (Formulari K-LNSN)" i cili është dhënë në Aneksin 7 të kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(10) Kërkesës nga paragrafi (8) i këtij neni i bashkëngjitet dokumentacioni vijues:

1. Vendim nga organi kompetent i shoqërisë së sigurimeve e cila ndahet, për fillimin e procedurës së

ndarjes;

2. Plan për ndarje i sjellë nga bordi mbikëqyrës i shoqërisë së sigurimit, gjegjësisht nga organi drejtues i shoqërisë që ndahet, i cili duhet të përmbajë në mënyrë adekuate të dhënat e përcaktuara me Ligjin për shoqëri tregtare.

(11) Në rastet e ndarjes me shkëputje me themelim ose me veçim me themelim, përveç dokumentacionit të përmendur në paragrafin (10) të këtij neni, kërkesës për marrjen e lejes për ndryshime të statusit i bashkangjitet edhe dokumentacioni vijues:

3. Bilanc fillestar i gjendjes së shoqërisë së re të sigurimeve nga i cili mund të shihet shuma e kapitalit të saj fillestar. Bilanci fillestar merret pas ndarjes së kërkesave dhe detyrimeve të shoqërisë së sigurimit e cila ndahet dhe patjetër të reshikohet nga një revizor i autorizuar;
4. Dëshmi se shuma e duhur e parave që kërkohen për të arritur kapitalin fillestar është paguar në llogarinë e përkohshme të bartësit të operacioneve të pagesës, nëse me ndarjen e shoqërisë nuk është siguruar shuma e duhur e kapitalit fillestar të shoqërive ose kompanive të reja për sigurim; dhe
5. Dokumentacioni i përshtatshëm nga neni 2 paragrafi (3) pikat 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe paragrafi (4), (5), (6) dhe (7) të kësaj rregulloreje;
6. Dëshmi për tarifën e paguar për lëshimin e lejes për ndryshimin e statusit, në pajtueshmëri me Tarifën e Agjencisë.

(12) Në rastet e shkëputjes me transferim dhe veçimit me transferim, përveç dokumentacionit të paragrafit (10) të këtij neni, kërkesës për marrjen e lejes për ndryshime të statusit i bashkangjitet edhe dokumentacioni vijues:

- Statuti i ri i mundshëm ose i ndryshuar i shoqërisë së sigurimeve e cila ndahet edhe me shoqëritë ekzistuese për sigurim, i cili duhet të përmbajë të dhënat e parashikuara në nenin 2 paragrafi (3) pika 1 të kësaj rregulloreje.
- Plani strategjik dhe operacional për punën për arsyetimin ekonomik të ndarjes, i cili duhet të përfshijë analizë të nevojës për ndarje si dhe parashikime të pasqyrave financiare, i përpiluar për shoqërinë e sigurimit e cila ndahet edhe me shoqëritë ekzistuese të sigurimit, në pajtueshmëri me nenin 2 paragrafi (3) pika 2 të kësaj rregulloreje;
- Nëse ka një ndryshim në strukturën organizative të kompanisë së sigurimit që ndahet edhe me kompanitë ekzistuese, struktura e re organizative duhet të dorëzohet me të dhëna për fushën e veprimit dhe përgjegjësitë e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, për secilën pjesë organizative, marrëdhëniet mes tyre dhe marrëdhëniet me organet mbikëqyrëse dhe drejtuese të shoqërisë e cila ndahet edhe me shoqëritë ekzistuese, si dhe numrin eventual të nevojshëm të të punësuarve bashkë me strukturën e tyre të kualifikimit;
- Bilancet e shoqërisë së sigurimit që ndahet edhe me kompanitë ekzistuese të sigurimit, nga të cilat mund të shihet shuma e kapitalit të shoqërisë së sigurimit që ndahet edhe me kompanitë ekzistuese të sigurimit. Bilancet merren pas ndarjes dhe/ose konsolidimit të kërkesave dhe detyrimeve të shoqërisë së sigurimit e cila ndahet dhe patjetër duhet të rishikohen nga një revizor/auditues i autorizuar;
- Të dhëna për numrin dhe arsimimin e të punësuarave të marrë nga kompania e sigurimit e cila ndahet, si dhe për të punësuarit e marrë të cilët në shoqëritë ose kompanitë ekzistuese të sigurimit do të kenë status të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, si dhe të dhëna edhe për historinë e tyre profesionale;
- Dokumentacioni nga nenin 2 paragrafi (3) pikat 7) dhe 8) dhe neni 3 të kësaj rregulloreje, nëse me ndarjen shkaktohen ndryshime në anëtarët e bordit drejtues ose mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit e cila ndahet ose të kompanive ekzistuese të sigurimit ose në klasat e sigurimit të cilat do të kryejnë shoqëria e sigurimit që ndahet, gjegjësisht kompanitë ekzistuese të sigurimit, për të cilat në pajtueshmëri me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimit

- kërkohe miratim edhe nga Agjencia;
- Dokumentacioni i nenit 2 paragrafi (4) dhe (5) të kësaj rregulloreje, nëse me ndarjen shkaktohen ndryshime në strukturën aksionare të kompanive ekzistuese të sigurimit.

(13) Në rastet kur ndryshimi i statusit krijon persona të rinj juridikë që nuk janë shoqëri të sigurimit, për themelimin dhe funksionimin e të cilave, në përputhje me rregullat ekzistuese, kërkohe leje, miratim ose ndonjë lloj tjetër të miratimit nga organi i autorizuar ose kompetent në vend, personat e rinj juridikë detyrohen të fillojnë një procedurë të veçantë për marrjen e miratimit të nevojshëm.

VII. DHËNIA E LEJES PËR THEMELIMIN DHE FUNKSIONIMIN E FILIALIT TË SHOQËRISË SË HUAJ TË SIGURIMEVE

Neni 7

(1) Për dhënien e lejes për themelimin dhe funksionimin e filialit të kompanisë së huaj të sigurimeve në territorin e Republikës së Maqedonisë, në Agjenci dorëzohet kërkesë për marrjen e lejes për themelimin dhe funksionimin e filialit (degës) së kompanisë së huaj të sigurimeve.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni do të dorëzohet vetëm në formularin e paraparë: "Kërkesë për marrjen e lejes për themelimin dhe funksionimin e filialit të kompanisë ose shoqërisë së huaj të sigurimeve (Formulari K-FSHS)" i cili është bashkangjitur si Aneksi 9 i kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(2) Kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni i bashkëngjitet dokumentacioni vijues:

- 1) Vendim i organit kompetent administrues i kompanisë së huaj të sigurimeve për hapjen e filialit (degës) në Republikën e Maqedonisë;
- 2) Leje e lëshuar nga organi shtetror mbikëqyrës në vend në të cilën është regjistruar selia e shoqërisë së huaj të sigurimeve, ku përcaktohen veprimtaritë e sigurimeve për të cilat është e autorizuar t'i kryejë kompania e huaj e sigurimeve;
- 3) Leje nga organi kompetent shtetror mbikëqyrës në vend në të cilën është regjistruar selia e kompanisë së huaj për sigurim për të hapur filial në Republikën e Maqedonisë ose njoftim që nuk kundërshton hapjen e filialit në Republikën e Maqedonisë;
- 4) Statut të shoqërisë së huaj të sigurimeve ose akt tjetër të duhur në përputhje me rregulloret e vendit në të cilin është regjistruar selia e shoqërisë së huaj të sigurimeve;
- 5) Certifikatë nga regjistri në të cilin është regjistruar selia e shoqërisë së huaj të sigurimeve;
- 6) Listë e aksionarëve të shoqërisë së huaj të sigurimeve të cilët zotërojnë më shumë se 10% të aksioneve të shoqërisë së huaj të sigurimeve, përveç nëse të njëjtët nuk përcaktohen në dokumentin e pikës 7 të këtij paragrafi;
- 7) Kopje të vendimit për regjistrim në regjistrin tregtar ose regjistrin përkatës nga vendi ku gjendet selia e personave juridikë që posedojnë më shumë se 10% të aksioneve të shoqërisë së huaj të sigurimeve;
- 8) Pasqyra financiare të rishikuara të shoqërisë së huaj të sigurimeve për tre vitet e fundit të punës;
- 9) Draft-statuti i filialit;
- 10) Plan të punës së filialit për dy vite pune i cili duhet të përmbajë të paktën të dhënat e nenit 2 paragrafi (3) pika 2) të kësaj rregulloreje;
- 11) Dokumentacion në bazë të të cilit vërtetohet se janë plotësuar kushtet në lidhje me anëtarët e propozuar që do të drejtojnë filialin e shoqërisë së huaj të sigurimeve, i cili është paraparë për dhënien e miratimit për kryerjen e funksionit anëtar të organit drejtues në Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e pëlqimit nga Agjencia për Mbikëqyrjen e sigurimeve në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve;
- 12) Deklaratë nga organi kompetent administrues i shoqërisë së huaj të sigurimit që dega (filiali) në selinë e saj do të mbajë të gjithë dokumentacionin në lidhje me funksionimin (punën) e filialit (degës);

- 13) Dëshmi se janë përmbushur kushtet e nenit 63 paragrafi (2) pikat 3 dhe 4 të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve në lidhje me fondin e garancisë minimale dhe depozitën monetare;
- 14) Dokumentacion i cili mund të vërtetojë që filiali është i pajisur në aspektin kadrovik, teknik dhe organizativ për të kryer aktivitetet e përcaktuara në kërkesën për marrjen e lejes për themelimin dhe funksionimin e filialit; dhe
- 15) Dokumentacion i nenit 2 paragrafi (3) pikat 2, 3, 4, 5 dhe 15 të kësaj rregulloreje;

(2) Kur vendoset lidhur me kërkesën e dorëzuar për marrjen e lejes për themelimin dhe funksionimin e filialit të kompanisë së huaj për sigurime në territorin e Republikës së Maqedonisë, vlerësimi i nenit 2 paragrafi (14) të kësaj Rregulloreje do të zbatohet siç duhet si dhe do të bëhet:

- vlerësim i rregulloreve dhe praktikave mbikëqyrëse të vendit të origjinës së kompanisë së huaj të sigurimeve dhe a mund të realizohet bashkëpunim me organin kompetent mbikëqyrës të këtij vendi, në drejtim të respektimit të parimeve dhe standardeve ndërkombëtare për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacionit për kryerjen efikase të mbikëqyrjes ;
- analizë e rregullave dhe praktikave të vendit të origjinës së kompanisë së huaj të sigurimeve në fushën e raportimit financiar dhe kontabilitetit, parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, etj., në aspektin se a ekziston rrezik që mund të çënojë stabilitetin, sigurinë dhe reputacionin e kompanisë së sigurimit, përkatësisht punën e saj në përputhje me rregulloret.
- vlerësim të mundësive që kompanitë e sigurimit me seli në Republikën e Maqedonisë të kryejnë aktivitete sigurimesh në vendin në të cilin është vendosur zyra qendrore e kompanisë së sigurimit e cila formon filialen si dhe mundësitë konkurruese për të kryer veprimtari sigurimi nga kompanitë e sigurimeve me seli në Republikën e Maqedonisë si dhe kompanitë nacionale për sigurim përsa u përket rregulloreve dhe praktikave të përvetësuara me zbatimin e këtyre rregulloreve në atë vend.

Specifikimi i formës së dorëzimit të dokumentacionit Neni 8

(1) Kërkesës për dhënien e lejes nga neni 1 i kësaj rregulloreje i bashkangjiten të dhënat për personin e autorizuar për kontakt me Agjencinë (emrin dhe mbiemrin, numrin e telefonit, numrin e faksit, posta elektronike).

(2) Dokumentacioni i dorëzuar me kërkesën për dhënien e lejes duhet të jetë origjinal ose i kopjuar por i vërtetuar nga një person i autorizuar (noter), i firmosur nga personi i autorizuar ose nga organi kompetent, pa korrigjime të mëtutjeshëm, në gjuhën maqedonase dhe e njëjta nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj para ditës së dorëzimit të kërkesës për dhënien e lejes. Nëse dokumenti që duhet të dorëzohet është në një gjuhë tjetër, bashkë me dokumentin origjinal dorëzohet edhe forma e përkthyer në gjuhën maqedonase, e përkthyer nga një përkthyes i certifikuar dhe e vërtetuar në noter.

(3) Deklaratat dhe pyetësorët që janë pjesë e dokumentacionit që dorëzohet me kërkesën për dhënien e lejeve duhet të vërtetohen te personi i autorizuar (noteri) dhe të njëjtët nuk duhet të jenë më të vjetër se gjashtë muaj ditën kur dorëzohet kërkesa për dhënien e lejes.

(4) Nëse legjislacioni i vendit të origjinës së personit të huaj që synon të themelojë një kompani të sigurimeve rregullon ndryshe lëndën lidhur me dokumentacionin që dorëzohet me kërkesën për dhënien e lejeve të nenit 1 të kësaj rregulloreje, atëherë duhet të dorëzohet dokumenti i duhur, ose mendim juridik nga avokati me çka do të mund të vërtetohet dallimi i rregullativës, gjegjësisht do të sigurohet dokument tjetër me çka do të vërtetohet plotësimi i detyrimit të paraparë ligjor.

(5) Agjencia shqyrton dhe vendos për kërkesat për leje me dokumentacionin e plotë. Me dokumentacionin e plotë nënkuptojmë dokumentacionin e përcaktuar me këtë rregullore, dokumentacionin i cili në mënyrë plotësuese kërkohet nga Agjencia, si dhe dokumentet, të dhënat dhe informatat e përshtatshme, të cilat duhet të fitohen nga insitucionet kompetente vendore dhe të huaja në vend dhe jashtë tij.

Vendimmarrja për kërkesën për marrjen e lejes për kryerjen e punëve të sigurimit dhe brokerimit

Neni 9

(1) Kur vendoset për kërkesën e nenit 2 paragrafi (1), nenit 3 paragrafi (1), nenit 4 paragrafi (1), nenit 5 paragrafi (1) dhe nenit 6 paragrafi (2), (4) dhe (6) dhe nenit 7 paragrafi (1) të kësaj rregulloreje, Agjencia vlerëson nëse janë përmbushur kushtet e parashikuara në Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve.

(2) Në lidhje me kërkesat e nenit 2 paragrafi (1) dhe nenit 6 paragrafi (2), (4) dhe (6) të kësaj rregulloreje, Agjencia sjell vendim për dhënien e lejeve dhe /ose për refuzimin e kërkesës, për një afat kohor prej 4 muajve nga dita e dorëzimit të kërkesës me dokumentacion të plotë në përputhje me këtë rregullore.

(3) Në lidhje me kërkesat e nenit 3 paragrafi (1), nenit 4 paragrafi (1), nenit 5 paragrafi (1) dhe nenit 7 paragrafi (1) të kësaj rregulloreje, Agjencia merr vendim për dhënien e lejes ose refuzimin e kërkesës, me afat kohor prej 2 muajve nga dita e dorëzimit të kërkesës me dokumentacion të plotë në përputhje me këtë rregullore.

Dispozitat përfundimtare

Neni 10

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Neni 7

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 35/2017)

Aneksi 1 zëvendësohet nga 8 Aneksë të reja që i bashkëlidhen kësaj rregulloreje dhe janë pjesë përbërëse të saj.

Neni 9

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 35/2017)

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën vijuese pas ditës së botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Neni 6

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 37/2019)

Shtojcat 1, 5, 6, 7 dhe 8 zëvendësohen me Aneksë të reja 1, 5, 6, 7 dhe 8 të cilët i bashkëlidhen kësaj rregulloreje dhe janë pjesë përbërëse të saj.

Pas Aneksit 8, shtohet Aneksi i ri 9, i cili i bashkangjitet kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 7

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 37/2019)

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën vijuese pas ditës së botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

KRYETAR I KËSHILLIT TË EKSPERTËVE
Klime Poposki

AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

KËRKESË²

PËR DHËNIEN E LEJES PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE TË SIGURIMIT

1.	Emri dhe mbiemri, ose emri i personave që synojnë të themelojnë kompaninë e sigurimit (shkruhen të gjithë veçmas bashkë me të dhënat për përqindjen në aksione me të drejtë vote në kompani)	
2.	Personi i autorizuar për kontakt me Agjencinë	
2.1.	Telefoni i personit të autorizuar	
2.2.	Adresa e postës elektronike të personit të autorizuar	
2.3.	Adresa e personit të autorizuar	

Kërkoj/më nga Agjencia për Mbiqëqyrjen e Sigurimeve të na japë leje për kryerjen e aktiviteteve të sigurimit në _____ (titulli/emri i propozuar i shoqërisë së sigurimit në themelim) me seli në rr. _____ nr. _____ në _____ (qytet).

Kërkesës i bashkangjis/bashknagjisim dokumentacionin e parashikuar në nenin 2 paragrafët (3), (4) dhe (6) dhe (3), (5) dhe (6) të "Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm i cili dorëzohet me kërkesën për marrjen e lejes në përputhje me Ligjin e Mbiqëqyrjes të Sigurimeve"³ (secili dokument deklarohet veçmas):

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____
10. _____
11. _____

¹Rekomandohet që kërkesa të plotësohet në mënyrë elektronike. Versioni elektronik i Kërkesës mund të gjendet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbiqëqyrjes së Sigurimeve . Nëse Kërkesa nuk plotësohet në mënyrë elektronike, domosdoshmërisht duhet të përdoret stiloaps dhe duhet të plotësohet me shkronja të mëdha.

²Dokumentacionin nga neni 2 paragrafi (4) pika 9) nën-pikat 9.3, 9.4 dhe 9.5, paragrafi (5) pika 7) nën-pika 7.1, pika 10) nën-pikat 10.3, 10.5 dhe 10.6 dhe pikat 13) dhe 14) të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm i cili dorëzohet me kërkesën për marrjen e lejes në pajtueshmëri me Ligjin për Mbiqëqyrjen e Sigurimeve, Agjencia do ta sigurojë në mënyrë zyrtare nga organi publik kompetent (nëse i njëjti dokumentacion nuk dorëzohet nga kërkuesi (parashtruesi), për të cilën kërkuesi do të bëjë një deklaratë që autorizon Agjencinë në emër të tij/saj dhe në llogari të tij/saj t'i përdorë të dhënat që përmbahen në këtë Formular dhe në Agjenci të dorëzohet dëshmi për pagesën e kryer në llogarinë e institucionit përgjegjës për lëshimin e dokumentit të duhur me shumën e përcaktuar nga tarifa e përcaktuar me ligj. Vërtetimin nga neni 2 paragrafi (3) pika 8, nën-pika 8.4 dhe paragrafi (4), pika 5 të këtij neni, Agjencia në mënyrë zyrtare do ta marrë nga gjykata përkatëse kompetente (nëse i njëjti nuk paraqitet nga kërkuesi). Nëse personi është person i huaj, ai /ajo është i detyruar të sigurojë vetë informacionin e tillë nga autoritetet kompetente në vendin e huaj . Dëshminë që personi i propozuar si anëtar i organit mbiqëqyrës të kompanisë nuk është anëtar i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë, Agjencia zyrtarisht e siguron nga evidenca e saj.

DEKLARATË E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS

Me parashtrimin e kësaj kërkesë, unë deklaroj që të dhënat dhe informacionet në këtë kërkesë, si dhe i gjithë dokumentacioni që i bashkangjes kërkesës për dhënie e lejes për të kryer aktivitete të sigurimeve, janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara dhe në rast të ndryshimit të të dhënave të përfshira në këtë kërkesë, si dhe të dokumenteve të bashknagjitura me këtë kërkesë, për një afat kohor prej 3 ditë pune nga bërja e ndryshimit, do ta njoftojë Agjencinë.

Me dorëzimin ose parashtrimin e kësaj kërkesë jam dakord të përdoren të dhënat e mia personale të përfshira në këtë kërkesë në procedurën për realizimin e të drejtës time për të marrë dëshmi dhe të dhëna të nevojshme nga organet e tjera publike kompetente në mënyrë zyrtare dhe të njëjatat të përdoren në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Data dhe vendi i dorëzimit

_____. ____ 20____

Nënshkrimi i parashtruesit të kërkesës⁴

³ Kërkesën e firmosin personat fizikë ose përfaqësuesit e autorizuar të personave juridikë që synojnë të themelojnë kompaninë e sigurimit

AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

KËRKESË¹

PËR DHËNIEN E E LEJES PËR FILLIMIN E KLASËS SË RE TË SIGURIMIT

1.	Emri i shoqërisë së sigurimeve	
2.	Personi i autorizuar për kontakt me Agjencinë	
2.1.	Telefoni i personit të autorizuar	
2.2.	Adresa e postës elektronike e personit të autorizuar	
2.3.	Adresa e personit të autorizuar	

Kërkoj/kërkojmë nga Agjencia e Mbiqëqyrjes së Sigurimeve të japë leje për fillimin ose futjen e klasës së sigurimit _____ nga grupi i _____ në aktivitetin e kompanisë së sigurimeve.

Kërkesës i bashkangjes/bashkangjesim dokumentacionin e parashikuar në nenin 3 paragrafi (3) të "Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm i cili dorëzohet me kërkesën për marrjen e lejes në përputhje me Ligjin për Mbiqëqyrje të Sigurimeve " dhe (qarkohet ose shënohet nëse plotësohet në mënyrë elektronike):

1.	Vendim për futjen e klasës së re të sigurimeve, të miratuar nga organi kompetent i shoqërisë së sigurimeve;
2.	Plan të punës (të ndryshuar dhe të plotësuar)
3.	Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të sigurimit së bashku me Vendimin për miratimin e Kushteve të përgjithshme dhe të veçanta gjegjësisht ndryshimet e tyre.
5.	Tarifa e primeve së bashku me Vendimin për miratimin e Tarifës gjegjësisht ndryshimet e saj
6.	Bazat teknike për llogaritjen e tarifave
7.	Mendim nga aktuari i autorizuar sa u përket Kushteve dhe Tarifave
8.	Propozim-aktet të tjera të politikës tregtare të shoqërisë
9.	Vërtetim nga aktuari i autorizuar që kompania e sigurimit mund të sigurojë nivelin e kërkuar të marzhit të aftësisë paguese sipas llojit dhe fushës së planifikuar të aktiviteteve
10.	Dëshmi për tarifën e paguar për dhënie e lejes për futjen ose fillimin e klasës së re të sigurimit, sipas Tarifës së Agjencisë.

DEKLARATË E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS

Me parashtrimin e kësaj kërkesë, Deklaroj që të dhënat dhe informacionet në këtë kërkesë, si dhe i gjithë dokumentacioni që i bashkangjes kërkesës për dhënie e lejes për të kryer aktivitete sigurimi, janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara dhe në rast të ndryshimit të të dhënave të përfshira në këtë kërkesë, si dhe të dokumenteve të bashknagjitura me këtë kërkesë, për një afat kohor prej 3 ditë pune nga ndodhja e ndryshimit, do ta njoftojë Agjencinë.

Data dhe vendi i dorëzimit

Nënshkrimi i parashtruesit të kërkesës²

_____. 20_____

¹Rekomandohet që Kërkesa të plotësohet në mënyrë elektronike. Versioni elektronik i Kërkesës mund të gjendet në faqen zyrtare të Agjencisë për Mbiqëqyrjen e Sigurimeve . www.aso.mk. Nëse Kërkesa nuk plotësohet në mënyrë elektronike, domosdoshmërisht duhet të plotësohet me stilolaps dhe duhet të plotësohet me shkronja të mëdha.

² Kërkesa nënshkruhet nga personi i autorizuar i kompanisë së sigurimeve.

AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

KËRKESË¹

PËR DHËNIEN E LEJES PËR MBARTJEN (TRANSFERIN) E PORTOFOLIT SIGURUES

1.	Emri i kompanisë së sigurimeve që synon të transferojë portofolin e sigurimeve	
2.	Personi i autorizuar për kontakt me Agjencinë	
2.1.	Telefoni i personit të autorizuar	
2.2.	Adresa e postës elektronike e personit të autorizuar	
2.3.	Adresa e personit të autorizuar	

Kërkoj nga Agjencia e Mbiqëqyrjes së Sigurimeve të më japë leje të transferojë portofolin e sigurimeve nga klasa/t e sigurimit _____ (Emri i klasës/ave të sigurimit që janë lëndë e bartjes së portofolit të sigurimit) në kompaninë e sigurimit _____ (Emri(titulli) i kompanisë së sigurimit) që synon të marrë përsipër portofolin e sigurimeve).

Kërkesës i bashkangjis/bashkangjisim dokumentacionin e parashikuar në nenin 4 paragrafi 4 të "Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm i cili dorëzohet me kërkesën për marrjen e lejes në përputhje me Ligjin për Mbiqëqyrje të Sigurimeve " dhe (qarkohet ose shënohet nëse plotësohet në mënyrë elektronike):

1.	Vendim për transferimin e portofolit të sigurimeve, i miratuar nga organi kompetent i kompanisë që transferon portofolin;
2.	Vendim për marrjen e portofolit të sigurimeve, i miratuar nga organi kompetent i shoqërisë ose kompanisë që ndërmerr portofolin
